

Delegacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit merr pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 25 vjetorit të krijimit të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut



Më datat 26 dhe 27 Nëntor 2024, delegacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit mori pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 25 vjetorit të krijimit të Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në krenim të këtij përvjetori, nën organizimin e ESHR-së dhe pjesërisht të mbështetur edhe nga EUROSAI, në Shkup u organizua konferenca me temë “Shkëmbimi i përvojave në proceset e komunikimit të Institucioneve Supreme të Auditimit me palët e interesuara – mundësitë dhe sfidat”, e cila mbledhi ekspertë nga organizata

ndërkombëtare të ndryshme, Institucione Supreme të Auditimit dhe organizata profesionale. Sesioni i parë i konferencës u fokusua në transparencën dhe rëndësinë e komunikimit të qartë të gjetjeve të auditimit si bazë për ndërtimin e besimit dhe nxitjen e reagimeve në kohë, ndërsa sesioni i dytë i kushtua zbatimit të mjeteve dhe teknologjisë inovative të komunikimit, të cilat përmirësojnë procesin e auditimit dhe rrisin transparencën.



Gjatë fjalës hapëse të konferencës z. Acevski, Kryerevizori Shtetëror, falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, si dhe për kontributin e deritanishëm të institucionit si një dëshmi e përkushtimit për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të mirë, duke theksuar rëndësinë e krijimit të partneriteteve të forta dhe nxitjes së besimit të të gjitha palëve të përfshira. Konferenca u pasua me përshëndetjen e përfaqësuesve të Kuvendit, ambasadave, organizatave ndërkombëtare, medias, si dhe të Institucioneve Supreme të Auditimit të Izraelit, Norvegjisë, Kosovës dhe Bullgarisë, të cilët shprehën urimet e tyre për përvjetorin e krijimit të Entit

Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përmbledhur arritjet kryesore përgjatë këtyre viteve sipas fushave respektive.

Në përfundim, z. Acevski shprehu rëndësinë e këtij momenti të rëndësishëm për ESHR-në, jo vetëm për të shënuar historinë e saj 25-vjeçare, por edhe për të parë drejt së ardhmes, duke theksuar përkushtimin ndaj parimeve të paanshmërisë, transparencës dhe zhvillimit të vazhdueshëm të proceseve të auditimit dhe llogaridhënies publike.

Ky eveniment ishte një mundësi e shkëlqyer takimi për përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Zyrës së Auditimit të Kosovës dhe të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut .

